



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA
GJYKATA THEMELORE MITROVICË

Numri i lëndës: 2023:049134
Datë: 20.03.2024
Numri i dokumentit: 05478002

C.nr.236/2023

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË, si kontestimore, me gjyqtarin individual Blerim Istrefi, në çështjen juridike kontestimore të paditësve: F.R, E.Ç, M.I, V.U dhe Q.B që të gjithë nga M, të cilët sipas autorizimit i përfaqëson L.A avokat në M, kundër të paditurës: Komuna e Mitrovicës-Drejtoria Komunale e Arsimit, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson L.Z avokat në P, lidhur me çështjen kontestuese kompensim i ushqimit-shujtë ditore, vlera e kontestit 4.040 euro, jashtë seancës konform nenit 398 të LPK-së, me datë 20.03.2024 mori këtë:

A K T G J Y K I M

I.APROVOHET si e bazuar kërkesëpadia e paditësve F.R, E.Ç, M.I, V.U dhe Q.B që të gjithë nga M ashtu që **DETYROHET** e paditura Komuna e Mitrovicës-Drejtoria Komunale e Arsimit, që paditësve, në emër të kompensimit për ushqim gjatë pranisë në punë (shujtave ditore ne shumen prej 2 euro) për periudhën kohore 21.01.2021 e deri më datë 22.11.2022, ti kompensoj shumat si vijon:

- Paditëses F.R në emër të kompensimit për ushqim gjatë pranisë në punë (shujtave ditore) gjithsej 390 dite pune shumen prej 780euro;
- Paditëses E.Ç në emër të kompensimit për ushqim gjatë pranisë në punë (shujtave ditore ne shumen) gjithsej 390 dite pune shumen prej 780euro;
- Paditësit M.I në emër të kompensimit për ushqim gjatë pranisë në punë (shujtave ditore ne shumen) gjithsej 460 dite pune shumen prej 920 euro;
- Paditësen V.U në emër të kompensimit për ushqim gjatë pranisë në punë (shujtave ditore ne shumen) gjithsej 390 dite pune shumen pre780 euro;
- Paditësen Q.B në emër të kompensimit për ushqim gjatë pranisë në punë (shujtave ditore ne shumen) gjithsej 390 dite pune shumen pre780 euro;

Për secilin paditës veç e veç me kamatë ligjore prej 8%, duke llogaritur nga data 20.02.2023, datë e paraqitjes së padisë në gjykatë, e deri në pagesën përfundimtare, të gjitha këto (borxhin kryesor dhe kamatën) në afat prej 7 (shtatë) ditësh nga dita e marrjes së këtij Aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit të detyrueshëm.

II.APROVOHET PJESËRISHT SI E BAZUAR kërkesa e paditësve për kompensimin e shpenzimeve te procedurës ashtu që **DETYROHET** e paditura Komuna e Mitrovicës-Drejtoria Komunale e Arsimit - t'ia paguaj paditësve shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë të

përgjithshme prej 352.00€, të gjitha në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimit, nën kërcënim të përbarimit të detyrueshëm.

III.REFUZOHET Pjesërisht si e pa bazuar përtej pjesës së aprovuar si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi kërkesa e paditësve lidhur me shpenzimet e procedurës kontesimore, me të cilën ka kërkuar në emër të precizimit të kërkesëpadisë t'ia paguaj e paditura shumën prej 312.00 €.

IV.KONSTATOHET E TEREQHUR kërkesëpadia e paditësve për kompensimin e shpërblimit në lartësi prej 8.3% të pagës vjetore kumulative.

A r s y e t i m

Paditësit përmes të autorizuarit të tyre, me datë 20.02.2023 kanë ushtruar padi kundër të paditurës Komuna e Mitrovicës-Drejtoria Komunale e Arsimit, me të cilën kanë kërkuar kompensimin për ushqim në emër të ditëve të pranisë në punë (për secilën ditë të pranisë në punë nga 2 euro), për periudhën kohore 21.01.2021 e deri me datën 22.11.2022 me kamatë ligjore prej 8 %, duke u bazuar në Kontratën Kolektive të Arsimit në Kosovës e datës 22.01.2021 (*tutje si KKAK*). Me parashtrësën e datës 14.11.2023 përfaqësuesi i paditësve ka precizuar kërkesëpadinë e cili ka kërkuar që në emër të shujtës ushqimore për paditësen F.R në emër të kompensimit për ushqim gjatë pranisë në punë (shujtave ditore) gjithsej 390 dite pune t'i paguaj shumën prej 780 euro, për paditësen E.Ç në emër të kompensimit për ushqim gjatë pranisë në punë (shujtave ditore në shumën) gjithsej 390 dite pune t'i paguaj shumën prej 780 euro, për paditësen M.I në emër të kompensimit për ushqim gjatë pranisë në punë (shujtave ditore në shumën) gjithsej 390 dite pune t'i paguaj shumën prej 780 euro, për paditësen Q.B në emër të kompensimit për ushqim gjatë pranisë në punë (shujtave ditore në shumën) gjithsej 390 dite pune t'i paguaj shumën prej 780 euro. Ndërsa i njëjti ka deklaruar se tërhiqemi padinë sa i përket kompensimit për 8.3% të pagës vjetore kumulative për shkak se e paditura nuk ka vepruar sipas kërkesës për lëshimin e vërtetimeve për performancën e paditësve.

Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar dhe atë për përpilimin e padisë shumën prej 312.00 €, në emër të precizimit të kërkesëpadisë shumën prej 312.00 euro si dhe në emër të taksës gjyqësore shumën prej 41.00€.

Gjykata në këtë çështje juridike kontestimore pas shqyrtimit paraprak të padisë ka nxjerrë aktvendimin për përgjigje në padi me datë 05.02.2024, të cilin e paditura e ka pranuar me datë 08.02.2024 (e cila është konfirmuar përmes fletë kthesës, e cila gjendet në shkresat e lëndës).

E paditura në përgjigjen në padi ka theksuar se e konteston në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë e paditësve sepse të njëjtit nuk kanë bashkangjitur dëshmi për të vërtetuar numrin e ditëve të pranisë në punë si dhe nuk e kanë përcaktuar periudhën kohore për të cilën kërkojnë kompensimin për shujta ushqimore për ditët e pranisë në punë. Andaj në baze të lartcekurave kërkon nga gjykata që të refuzoj padinë dhe kërkesëpadinë e paditësve në tërësi si të pa bazuar si dhe kërkon që paditësit të obligohen që t'i paguajnë të gjitha shpenzimet e procedurës.

Pasi që Gjykata bëri vlerësimin e provave të bashkangjitura padisë, si dhe pas pranimit të përgjigjes në padi, mbështetur në nenin 8, 398 të LPK-së, ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet ligjore për marrjen e aktgjykimit jashtë seancës.

Nga shqyrtimi i shkresave të lëndës dhe vlerësimi i përgjigjes në padi, gjykata konstatoi se: Në mes palëve ndërgjyqësve nuk është kontestuese se paditësit janë në marrëdhënie pune tek e paditura, megjithatë gjykata këtë e vërtetoi, nga provat e bashkangjitura padisë dhe atë:

Për paditësen F.R;

Nga vërtetimi mbi ditët e pranisë në pune të lëshuar nga drejtori i shkollës SH.F.M.U “Migjeni” në Mitrovicë me nr. të protokollit 166/23te datës 13.11.20223 vërtetohet fakti se paditësja ka qenë prezent në punë për 390 dite pune.

Për paditësen E.Ç;

Nga vërtetimi mbi ditët e pranisë në pune të lëshuar nga drejtori i shkollës SH.F.M.U “Migjeni” në Mitrovicë me nr. të protokollit 166/23te datës 13.11.20223 vërtetohet fakti se paditësja ka qenë prezent në punë për 390 dite pune.

Për paditësin M.I;

Nga vërtetimi mbi ditët e pranisë në pune të lëshuar nga drejtori i shkollës SH.F.M.U “Migjeni” në Mitrovicë me nr. të protokollit 166/23te datës 13.11.20223 vërtetohet fakti se paditësja ka qenë prezent në punë për 460 dite pune.

Për paditësen V.U;

Nga vërtetimi mbi ditët e pranisë në pune të lëshuar nga drejtori i shkollës SH.F.M.U “Migjeni” në Mitrovicë me nr. të protokollit 166/23te datës 13.11.20223 vërtetohet fakti se paditësja ka qenë prezent në punë për 390 dite pune.

Për paditësen Q.B;

Nga vërtetimi mbi ditët e pranisë në pune të lëshuar nga drejtori i shkollës SH.F.M.U “Migjeni” në Mitrovicë me nr. të protokollit 166/23te datës 13.11.20223 vërtetohet fakti se paditësja ka qenë prezent në punë për 390 dite pune.

Sipas nenit 329 par. 1 të LPK-së: Shkresa të cilën e ka hartuar në formën e caktuar organi shtetëror brenda kufijve të kompetencës së vet, si dhe shkresa të cilën në formë të tillë e ka hartuar ndërmarrja apo organizata tjetër në ushtrimin e autorizimeve publike që i janë besuar me ligj (dokumenti publik), provon saktësinë e asaj që konfirmohet apo caktohet në të. Së këndejmi, provave që kishin të bënin me vërtetimin e fakteve lidhur me ditët e prezencës në punë, gjykata i'u fali besimin e plotë, ngase është bërë e besueshme fuqia provuese e tyre.

Gjykata nga administrimi i provave vërtetoi këtë gjendje faktike;

Faktin se paditësit janë të punësuar tek e paditura vërtetohet përmes vërtetime mbi ditët e prezencës në punë të lëshuar nga drejtori i shkollës SH.F.M.U “Migjeni” në Mitrovicë, andaj lidhur me kompensimin e shujtës ditore për ditët e pranisë në punë, ka vendosur si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi dhe ka obliguar të paditurën që paditësve t’ia kompensoj shumën e përcaktuara si në pikën dy (I), pasi që u vërtetua fakti se paditësit kishin punuar te e paditura dhe ende vazhdojnë të punojnë, dhe të njëjtëve nuk i është paguar kompensimi në emër të ushqimit në punë (shujtave ditore), të parapara me nenin 35 paragrafi 7 të KKAK-së, me të cilën përcaktohet se: *“Të punësuarve iu njihet e drejta për ushqim gjate punës për ditët e pranisë në punë. Vlera e kompensimit të ushqimit për një ditë të pranisë në punë është 2 euro, për të punësuarit që kanë marrëdhënie primare të punës në institucione arsimore. Punëdhënësi i cili e ka të rregulluar ushqimin e të punësuarve përmes restaurantit apo kuzhinës apo ndonjë forme tjetër nuk e ka obligim për të bërë kompensimin”*. Nga interpretimi i kësaj dispozite, gjykata vlerëson se e njëjta dispozitë është detyruese për të paditurën andaj edhe e ka detyruar të njëjtën që ti kompensoj në emër të ushqimit (shujtës ditore) për periudhën kohore të cekur në dispozitiv përkatësisht për periudhën kohore nga data 21.01.2021 e deri me 22.11.2022.

Gjykata duke ju referuar Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë (KKAK), të nënshkruar nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe Sindikatës së Bashkuar të Arsimit, Shkencës dhe Kulturës dispozitat e së cilës aplikohen në tërë Republikën e Kosovës, ku në nenin 35 është paraparë e drejta punëtoreve të arsimit në kompensim në emër të ushqimit (shujtës ditore), si dhe gjeti se e njëjta është e aplikueshme nga hyrja në fuqi me datën 21.04.2021 e cila i u garanton punonjësve të arsimit këto të drejta.

Ndërsa lidhur me pretendimet e të paditurës të dhëna në përgjigjen në padi, se paditësit nuk i kanë bashkangjitur prova me të cilat dëshmojnë ditë e pranisë në punë, ky fakt nuk qëndron sepse në shkresat e lëndës është i bashkangjitur vërtetimi mbi ditët e pranisë në punë për secilin paditës veç e veç andaj edhe gjykata në baze të këtyre provave ka vendosur si në pikën I të dispozitivit me ku ka obliguar të paditurën që të bëjë kompensimin e kërkesave paditësve.

Nga të lartcekurat gjykata ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet për nxjerrjen e aktgjykimit aprovues jashtë seance, në kuptim të nenit 398 i LPK-së, sipas të cilit parashihet se “Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike, dhe se nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit meritor, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund ta jep aktgjykimin me të cilën e pranon si të themeltë kërkesëpadinë”. Duke qenë se ka lindur e drejta e paditësve për të kërkuar në rrugë gjyqësore realizimin e të drejtës për kompensim për ushqim (shujtë ditore), të njëjtit janë legjitimuar që të kërkojë përmbushjen e detyrimit nga e paditura, së këndejmi, paditësit e kanë rolin e kreditorit, kurse e paditura rolin e debitorit.

Në kuptim të nenit 245 të Ligjit nr. 04/L-077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve: “Kreditori në marrëdhënien e detyrimit ka të drejtë që prej debitorit të kërkojë përmbushjen e detyrimit, ndërsa debitori ka për detyrë ta përmbushë atë me ndërgjegje dhe në tërësi, në përputhje me përmbajtjen e tij”. Rrjedhimisht, duke qenë se e paditura i ka mbetur borxh paditësve, me aplikimin e

dispozitës së lartcekur dhe në bazë të gjendjes së vërtetuar faktike, vendosi që ta detyroj të paditurën që paditësve t'ia kompensoj shumën si në pikën I të dispozitivit të aktgjykimit.

Për kamatën gjykata ka vendosur duke u mbështetur në dispozitën e nenit 382 të LMD-së dhe Mendimit Juridike të Gjykatës Supreme të Kosovës për kamatën nr.265/2020 të datës 01.12.2020, ka marr datën e ushtrimit të padisë (data 23.02.2023), e ku lartësia e kamatës vjetor është e definuar 8% deri në pagesën definitive të detyrimit nga data 20.02.2023 si date e parashtrimit të padisë në gjykatë.

Gjykata vendosi si në pikën II të dispozitivit, në kuptim të nenit 452 të LPK-së ashtu që e detyrohet e paditura të paguaj shpenzimet e procedurës dhe atë për përpilimin e padisë shumen në lartësi prej 312.00€ - sipas tarifës së OAK, si dhe në emër të taksës gjyqësore shumen prej 40.00 euro

Ndërsa pjesën tjetër ka refuzuar pjesërisht si në pikën III të dispozitivit lidhur me shpenzimet sa i përket precizimit të kërkesëpadisë në shumën prej 312.00 €, pasi që precizimi i të njëjtës konsiderohet petitumi i padisë.

Me parashtrësën e datës 13.11.2023 përfaqësuesi i paditësve ka deklaruar se tërhiqet nga kërkesëpadia sa i përket e kompensimin e shpërblimit 8.3% të pagës vjetore kumulative andaj në baze të kësaj gjykata vendosi si në pikës IV të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Gjykata, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke i'u referuar dispozitës së nenit 398 të LPK-së, e në lidhje me dispozitat e nenit 35 par 7 të Kontratës Kolektive të Arsimit e datës:22.01.2021, dhe dispozitave të nenit 245 par.1 dhe 2, neni 249 parg.1 dhe 2 të LMD-së.

GJYKATA THEMELORE NË MITROIVCË
Departamenti i Përgjithshëm
C.nr.236/2023 me datën 20.03.2024

GJYQTARI
Blerim Istrefi

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 7 ditësh, nga dita e marrjes së të njëjtit, Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, përmes kësaj gjykatë.